

# Iniciativa Ndërinstitucionale për Zgjidhje të Qëndrueshme për Personat e Zhvendosur nga Kosova

## Përmbledhje

Në dhjetor të vitit 2014, UNHCR-ja dhe OSBE-ja mbështetën Ministrinë për Komunitete dhe Kthim (MKK) për të nisur një proces rajonal që i përkushtohet gjetjes së zgjidhjeve të qëndrueshme për personat e zhvendosur nga Kosova. Institucionet përkatëse nga Beogradi, Podgorica, Prishtina dhe Shkupi takohen rregullisht përmes këtij procesi rajonal me qëllim të mbështetjes së zgjidhjeve të qëndrueshme për popullsinë e zhvendosur.

## Pesë nëngrupet tematike zbatuese në Prishtinë (GPZ)

Pesë GPZ-të që përbëhen nga përfaqësues të institucioneve relevante të Kosovës vazhduan të takoheshin rregullisht gjatë vitit 2019, me qëllim të zbatimit të pikave të veprimit.

GPZ-të mbajtën 4 takime gjatë vitit 2019 lidhur me të drejtat pronësore, planifikimin e zgjidhjeve, menaxhimin e të dhënave si dhe sigurinë, dialogun dhe riintegrimin.

## Grupi Punues Teknik (GPT) për Zgjidhje të Qëndrueshme të Iniciativës Ndërinstitucionale për Personat e Zhvendosur nga Kosova ('Procesi i Shkupit')

GPT për Zgjidhje të Qëndrueshme u mbajt në Shkup të Maqedonisë së Veriut më 13 dhe 14 dhjetor 2018. Misioni i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në Kosovë dhe Shefi i Misionit të Zyrës së Komisionerit të Lartë të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Refugjat (UNHCR) në Kosovë lehtësuan takimin midis përfaqësuesve të institucioneve relevante nga Beogradi, Podgorica, Prishtina dhe Shkupi. Institucioni udhëheqës për këtë proces është Ministria për Komunitete dhe Kthim.



Gjatë takimit, delegacionet vlerësuan përparimin e arritur dhe diskutuan për veprimet e mundshme përcjellëse që do të kontribuonin më tej në zbatimin e pikave të veprimit në fushat e:

- Të drejtave pronësore
- Sigurisë, dialogut dhe riintegrimin
- Dokumenteve personale
- Menaxhimit të të dhënave
- Planifikimit të zgjidhjeve

---

## PËRMBLEDHJE E VEPRIMEVE TË DAKORDUARA:

- ✓ Në përputhje me Rregulloren për Kthimin e Personave të Zhvendosur dhe Zgjidhje të Qëndrueshme, u arrit në përfundim se informacioni rreth procedurave të aplikimit, kritereve dhe ndihmës potenciale duhet të ndahet me personat e zhvendosur në rajon.
- ✓ GPT propozoi që sapo të bëhet funksionale baza e të dhënave e MKK-së, personat e zhvendosur të informohen rreth mundësive për të aplikuar nga distanca.
- ✓ Komunikimi i rritur dhe shkëmbimi i informatave në nivel ekspertësh duhet të vazhdojnë rregullisht në përpjekje për të kërkuar zgjidhjet teknike për çështjet specifike në kuadër të secilës fushë tematike.
- ✓ Të kushtohet vëmendje e menjëhershme që personat e zhvendosur ose përfaqësuesit e tyre të kyqen në planifikimin e zgjidhjeve të qëndrueshme.
- ✓ Themelimi i sistemit të menaxhimit të të dhënave mbetet një parakusht i rëndësishëm për të përcaktuar më tej rrugën drejt zhvillimit të programeve të zgjidhjeve konkrete dhe mëvonë mbledhjes së fondeve nëpërmjet një konference me donatorë.
- ✓ Përmes një Koncept Dokumenti për Zgjidhje të Qëndrueshme, të konceptohen zgjidhjet bazuar në të dhënat ekzistuese dhe vlerësimit ekzistues të nevojave si dhe bazuar në kontekstet.
- ✓ Përvoja e suksesshme duhet të merret parasysh gjatë zhvillimit të programeve të zgjidhjeve për personat e zhvendosur nga Kosova nën patronazhin e 'Procesit të Shkupit', pra praktikatat e mira nga Programi Rajonal i Strehimit (zakonisht i njohur si "Procesi i Sarajevës").

---

## ZBATIMI I PIKAVE TË VEPRIMIT:

- ✓ Gjatë periudhës shtator-nëntor 2018, Policia e Kosovës realizoi shumë fushata ndërgjegjësimi për të informuar banorët për mundësinë e punësimit në shërbim. Grupet e synuara përfshinin në mënyrë të veçantë gratë dhe komunitetet joshumicë. Si rezultat i procesit të rekrutimit, kadetët e rinj filluan me trajnimin në Akademinë e Policisë, duke përfshirë këtu edhe rekrutët nga komunitetet joshumicë.
- ✓ Në mars dhe prill të vitit 2019, Drejtoria e Policisë së Kosovës realizoi vlerësime për t'i identifikuar lokacionet që kanë nevojë për rekrutë të rinj, veçanërisht në vendet me shkallë më të lartë të krimit. Pritet që rekrutët e rinj të rivendosen në bazë të komunitetit që i përkasin dhe veçanërisht në zonat e banuara nga komunitetet joshumicë.
- ✓ Pas miratimit të "Udhëzimeve për reagim të mekanizmave të nivelit lokal ndaj incidenteve që kanë ndikim në komunitete", një tjetër dokument udhëzues i ngjashëm është në procesin e hartimit me qëllim që të ndihmojë Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit për t'i trajtuar, regjistruar dhe raportuar rastet e krimit të urrejtjes.

- ✓ Rregullorja nr. 01/2018 për Kthimin e Personave të Zhvendosur dhe Zgjidhje të Qëndrueshme lejon ZKKK-të që t'u lëshojnë aplikantëve certifikata vendbanimi për ta mundësuar qasjen e tyre më të lehtë në dokumentet personale. Kjo certifikatë vendbanimi është një shtojcë e bashkëngjitur Udhëzuesit<sup>1</sup> për zbatimin e Rregullores.
- ✓ MKK, me mbështetjen e UNHCR-së dhe OSBE-së, është e angazhuar në forcimin e kapacitetit të autoriteteve në nivelin lokal. Deri më tani, MKK-ja, me mbështetjen e UNHCR-së dhe OSBE-së, ka ofruar trajnime në 28 komuna (ku janë trajnuar mbi 280 zyrtarë) për t'i aftësuar në procesin e zbatimit të Rregullores nr. 01/2018 për Kthimin e Personave të Zhvendosur dhe Zgjidhje të Qëndrueshme. MKK-ja do të vazhdojë të organizojë takime rajonale për autoritetet lokale.
- ✓ Më 15 korrik 2019, Ministria e Punëve të Brendshme nënshkroi zgjatjen e Vendimit Ministror<sup>2</sup> duke u dhënë të drejtë të gjithë qytetarëve që kanë regjistruar faktet e gjendjes të tyre civile (lindjet, martesat dhe vdekjet) në zyrat e dislokume serbe nga 10 qershori 1999 dhe 14 shtatori 2016 që të aplikojnë për regjistrim civil në Regjistrin Qendror të Gjendjes Civile në Kosovë. Vendimi aktual do të jetë në fuqi deri më 31 dhjetor 2019 dhe do të lejojë regjistrimin e gjendjes civile në mënyrë që të sigurojë që asnjë person të mos mbetet pa regjistrimin e duhur të gjendjes civile, veçanërisht ata që i përkasin komuniteteve joshumicë.
- ✓ Më 20 gusht 2018, Qeveria e Kosovës ka aprovuar Udhëzimin Administrativ (UA) nr. 10/2018 për Procedurat e Skemës së Kompensimit për Zbatimin e Vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore Banësore. UA ka për qëllim sigurimin e bazave ligjore për kompensimin e të ashtuquajturave kërkesat e kategorisë "A" dhe "C". Sipas një vlerësimi të hershëm, siç pasqyrohet në Strategjinë e Kosovës për të Drejtat Pronësore, 3.2 milionë euro do të nevojiten për t'i kompensuar pronarët për 143 prona të kontestuara; sidoqoftë, sipas UA-së së lartpërmendur, përafërsisht 1.5 milion euro do të jetë kostoja për zgjidhjen e këtij problemi. Deri më tani, Qeveria e Kosovës ka ndarë 1.2 milion euro. Gjatë takimeve të GP-së në Procesin e Shkupit u theksua nevoja që qeveria t'i ndajë fondet e mbetura dhe të fillojë zbatimin e skemës së kompensimit. Me UA në fuqi, tani procesi duhet të fillojë dhe të zbatohet së shpejti.
- ✓ Zyra Ligjore e Qeverisë ka filluar procesin e hartimit të një Udhëzimi të ri Administrativ për procedurat e prishjes së strukturave ilegale të ndërtruara në tokën-parcelën e palëve të treta (relevante për personat e zhvendosur). Sidoqoftë, kjo çështje ka mbetur pezull.

**Korrik 2019**

<sup>1</sup> Udhëzues për zbatimin e Rregullores (QRK) - nr. 02/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme, i qasshëm në: <http://mzp-rks.org/en/documents/regulation-of-the-return.html>

<sup>2</sup> Vendim i Ministrisë së Punëve të Brendshme, nr. 785/2019 i datës 15 korrik 2019.